



Seria "imageRUNNER 2600"

PRINTERË SHUMËFUNKSIONALË, MONO A3, ROBUSTË, TË BESUESHËM DHE TEJET EFIKASË

Pajisjet optimale në treg të krijuara për të shkëlqyer në ambientet e zyrave bashkëkohore



PRODUKTIVITET



**LIDHJE PËR PAJISJET
PORTATIVE**



**KOMANDIMI DHE
MIRËMBAJTJA**



PRAKTICITET



SIGURIA

Canon

Seria "imageRUNNER 2600"



PRODUKTIVITET

- Rezultate të shpejta dhe kohë e shpejtë e nxjerrjes së printimit parë (FCOT)
- Personalizimi i aplikacioneve në ekran rrit efikasitetin e cikleve të punës
- Skanoni e konvertoni dokumente në skedarë PDF të kërkueshëm, "Microsoft Word" ose "Power Point"
- Funksion për pezullimin e printimit që të mund të kryeni rregullimet e fundit të cilësimeve përpara se të nxirrni produktin përfundimtar
- Administrimi inteligjent i materialit ju mundëson regjistrimin e deri në 30 llojeve të letrës dhe pikasjen automatike të përmasave
- Finitori i integruar opsional me lidhje pa kapëse dhe me kapëse të integruara manuale



PRAKTIKITET

- Përdorim intuitiv përmes një ekrani të madh me prekje e me ngjyra, me përdorim të ngjashëm me celularët inteligjentë
- Opsione të përparura përshatjeje e personalizimi sipas nevojave të cikleve të punës së përdoruesit
- Ndërfaqja e integruar e ekranit kryesor ju mundëson përzgjedhjen nga një meny e vetme të cilësimeve të përdorura më shpesh
- Rikuperim automatik nga modaliteti pasiv* duke e vënë letrën në vetëmbushësen DADF ose duke hapur xhamin
- Procese inovatore prodhimi, duke përfshirë skeletet e salduara, që garantojnë jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e pajisjes

* vetëm për "imageRUNNER 2645"

- Ndërrim i lehtë i fishekut të tonerit me teknologji kundër derdhjes
- Dizajni kompakt mundëson vendosje të ndryshme në zyrë



SIGURI

- Verifikimi i sistemit gjatë ndezjes mundëson vendosjen e masave të sigurisë për mbrojtjen e pajisjes nga modifikimet e paautorizuara
- Opsione të përparura për autentikimin në pajisje dhe me bazë reje kompjuterike
- Komandimi qendror i cilësimeve të sigurisë ul barrët e administrimit
- PDF e enkriptuara dhe me nënshkrim pajisjeje apo opsional sipas përdoruesit japin mundësinë e niveleve të tjera të sigurisë në autentikim
- Funksionet e PIN të sigurt dhe të pezullimit të detyruar të printimit e përmirësojnë edhe më konfidencialitetin e dokumenteve
- Masat e mëtejshme për t'u bërë ballë sulmeve të programeve keqdashëse ndaj rrjetit përmbajnë dhe integrimin e sistemit SIEM të palëve të treta
- Siguroni privatësinë e të dhënave tuaja në rrjet me anë të IPsec dhe filtrimit të portave



LIDHJE PËR PAJISJET PORTATIVE

- Opsione lidhjeje për LAN me valë dhe kod QR për punë nga tabletat dhe celularët
- Ndërfaqja në distancë që mbështet pajisjet portative me strukturë të optimizuar ekranit u mundëson përdoruesve t'i ndryshojnë cilësimet e punëve të printimit kudo që të ndodhen

- Mbështetje për "Mopria", "Apple Air Print", "Google Cloud Print" dhe "Windows 10 Print"
- Aplikacioni "Canon PRINT Business" i shton funksione të mëtejshme printimit e skanimit nga pajisjet portative
- Statusi i pajisjes dhe i pjesëve të konsumueshme mund të lexohet nga pajisjet e lidhura portative



KOMANDIMI DHE MIRËMBAJTJA

- Menaxhohini nga një pikë qendrore të gjitha pajisjet e rrjetit me opsione menaxhimi në distancë përmes resë kompjuterike
- Paketa e programeve për operatorët në distancë ofron akses alternativ në pajisje, duke simuluar pultin dhe tastet fizike në ekranin kompjuterik të rrjetit për përdorim në distancë të të gjitha funksioneve të sistemit
- Pajtueshmëria me zgjidhjet e softuerit "Canon uniFLOW" mundëson gjurmimin dhe raportimin e punëve të printimit
- Mirëmbajtja elektronike mund të kontribuojë në mosndërprerjen e punës përmes diagnostikimit në distancë, leximit të automatizuar të matësve dhe monitorimit të pjesëve të konsumueshme

FAKTE TË SHPEJTA

imageRUNNER 2625i

- Printim, fotokopjim, skanim, dërgim dhe faks opsional
- Ekran me prekje, me ngjyra, 7 in/17,8 cm WVGA
- Shpejtësia e printimit: 25 fq/min (A4)
- Rezolucioni i printimit: 1200x1200 dpi
- Printim dyanësh automatik
- Opsion për pllakë ose vetëmbushëse DADF (kapaciteti 50 fletë)
- Shpejtësia e skanimit: 25 in/min (A4, mono/ngjyra)
- Lidhje rrjeti, Wi-Fi, USB dhe me kod QR
- Kapaciteti maks. i mbushjes së letrës: 2300 fletë

imageRUNNER 2630i

- Printim, fotokopjim, skanim, dërgim dhe faks opsional
- Ekran me prekje, me ngjyra, 7 in/17,8 cm WVGA
- Shpejtësia e printimit: **30 fq/min** (A4)
- Rezolucioni i printimit: 1200x1200 dpi
- Printim dyanësh automatik
- **Standard DADF** (kapacitet 50 fletë)
- Shpejtësia e skanimit: **30 in/min** (A4, mono/ngjyra)
- Lidhje rrjeti, Wi-Fi, USB dhe me kod QR
- Kapaciteti maks. i mbushjes së letrës: 2300 fletë

imageRUNNER 2645i

- Printim, fotokopjim, skanim, dërgim dhe faks opsional
- Ekran me prekje, me ngjyra, 7 in/17,8 cm WVGA
- Shpejtësia e printimit: **45 fq/min** (A4)
- Rezolucioni i printimit: 1200x1200 dpi
- Printim dyanësh automatik
- **Standard DADF** (kapacitet 100 fletë)
- Shpejtësia e skanimit: **55 in/min** (A4, mono/ngjyra)
- Lidhje rrjeti, Wi-Fi, USB dhe me kod QR
- **Vetëriaktivizim nga modaliteti pasiv**
- Kapaciteti maks. i mbushjes së letrës: 2300 fletë

SHËRBIMET

STANDARDE

Veprimet rutinë të zyrës kryejini me siguri e lehtësi me anë të softuerit të integruar, duke përfshirë "uniFLOW Online Express" dhe shërbime të tjera të disponueshme, duke ofruar një mirëmbajtje dhe mbështetje tërësore për pajisjet



HARDUERI



SOFTUERI



SHËRBIMET

ME POROSI

Zgjidhni një shërbim me porosi që u përshatet nevojave të biznesit tuaj duke evituar barrët e panevojshme në menaxhimin e printimeve. Konsultohuni me ekspertët e "Canon" për kërkesat tuaja konkrete për gjetjen e opsionit të duhur të shërbimeve të menaxhuara të printimit

E OPTIMIZUAR

Zgjeroni aftësitë e resë kompjuterike me anë të sistemit tërësor të menaxhimit të printimeve "Canon uniFLOW Online"

Canon

Canon Inc.
canon.com

Canon Europe
canon-europe.com

Albanian edition
© Canon Europa N.V., 2019